

# RAPORT MONITORIMI

## Nr. 4

**mbi kufizimet e  
përdorimit  
të burimeve  
shtetërore në  
fushatën  
zgjedhore**

*Periudha*

*1 -25 mars 2021*

**Raportues:**

**Isuf Shehu, Gerta Meta  
(Alumni të ASP)**

Me bashkëpunimin e  
pedagogëve dhe stu-  
dentëve monitorues  
pranë universiteteve  
në shtatë rajone të  
vendit

**Projekti**

**"Forcimi i Transparencës  
së Zgjedhjeve në Shqipëri"**

**Ky projekt mbështetet nga ambasada e Mbretërisë së Holandës në Tiranë dhe programi i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian "Aksioni kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri"**



Kingdom of the Netherlands

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented  
by the Council of Europe

Ky raport pasqyron gjetjet e monitorimit të zbatimit të dispozitave të reja të Kodit Zgjedhor, në drejtim të:

- Praktikës ligjore dhe institucionale për zbatimin e kufizimeve mbi burimet shtetërore;
- Procesit të raportimit dhe kontrollit të veprimtarive të ndaluara të zyrtarëve qendrorë dhe vendorë;
- Aktet ligjore të miratuara në shkelje të ndalimeve të parashikuara në periudhën 4 mujore para zgjedhjeve.

### Praktika ligjore dhe institucionale për zbatimin e dispozitave

Pas rrëzimit të procedimit administrativ të Komisionerit Shtetëror ndaj kryetarit të bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj për promovime të objekteve të rindërtuara nga tërmeti, çështja u ankimua më datë 22 shkurt nga subjekti Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) pranë Kolegjit Zgjedhor. Kodi Zgjedhor, në nenin 145 të tij, përcakton ngritjen dhe detyrat e Kolegjit Zgjedhor pranë gjykatës së Apelit Tiranë, si një organ ad-hoc i drejtësisë ku mund të “... shqyrtohen ankesat e subjekteve zgjedhore kundër vendimeve të KQZ, kur ato çënojnë interesat e tyre të ligjshme...”.

Ankimimi i LSI u morr në shqyrtim nga Kolegji Zgjedhor dhe vendimi përkatës u mor brenda 9 ditëve pune ([vendimi nr. 2](#), datë 04.03.2021). Trupi gjykues argumentoi se: “... procedura administrative e ndjekur nga Komisioneri shtetëror dhe më pas edhe Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve, (vendimmarrja e të cilit kundërshtohet me padinë e ngritur), i referohet një personi të tretë (kryetarit të bashkisë Tiranë), jo subjekt zgjedhor. Kolegji Zgjedhor vlerëson se nuk ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e kësaj kërkesë padie...”. Gjithashtu, vendimi nënvizon: “...në referencë të nenit 158/2 të Kodit Zgjedhor, Kolegji vlerëson dërgimin e akteve për shqyrtim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”...

Pas këtij vendimi, subjekti LSI ka ndjekur rrugën e ankimimit pranë gjykatës administrative, padi e cila pritet të shqyrtohet mes

shumë çështjeve të tjera që presin rradhën në këtë gjykatë. Përfshirja në ping-pongun mes gjykatave dhe vonesave të proceseve normale gjyqësore, rrezikon që të shtyjë pas 25 prillit dhënien e verdiktit të fundit për këtë çështje të rëndësishme. Një praktikë e tillë është sigurisht demotivuese dhe do të zbehtë besimin e të gjithë aktorëve për funksionimin efektiv të kufizimeve të Kodit Zgjedhor mbi promovimin e veprimtarive publike të ndaluara të zyrtarëve të lartë në periudhën parazgjedhore. Me nisjen e fushatës zgjedhore, me ngarkesën e shtuar të detyrave të strukturës së KQZ, zbatimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor mbi kontrollin e veprimtarive të ndaluara të zyrtarëve qendrorë dhe vendorë rrezikon që të kthehet në një “mision të pamundur”.

### Raportimi i veprimtarive publike

Zyrtarët e lartë publikë qendrorë dhe vendorë ngarkohen nga [Kodi Zgjedhor](#) me detyrimin që të raportojnë paraprakisht pranë KQZ veprimtaritë e tyre publike në periudhën 4-mujore para zgjedhjeve. Deri më 25 mars, në ndërfaqen (<https://aktivitete.kqz.gov.al/>) rezultojnë se janë regjistruar 311 institucione publike, nga të cilat janë raportuar gjithsej 890 aktivitete nga vetëm 52 institucione. Vihet re që ka raportime nga ministri dhe institucione të reja vendore, por sërish procesi i raportimit nuk pasqyron realisht të gjitha aktivitetet promovuese që po zhvillohen në realitet nga zyrtarët në këtë periudhë të raportimit.

Deri më tani, KQZ nuk ka ndaluar ndonjë veprimtari publike të zyrtarëve, një detyrë e caktuar nga Kodi Zgjedhor në rastet kur konstatohet se veprimtaritë janë në kundërshtim me rregulloret e raportimit. Kjo gjithashtu një rezultat i paqartësive të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator si dhe interpretimit të tij nga vendimet e deritanishme të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve, i cili ka vendosur kushtëzimin e ndalimit të promovimeve të investimeve për të cilat janë vendosur **fonde rishtazi në dispozicion**. Në këto rrethana, ndalimi i një aktiviteti publik para zhvillimit të tij do të kërkonte jo vetëm kapacitete njerëzore në dispozicion nga ana e KQZ, por edhe akses dhe analizim të specializuar të veprimtarisë financiare dhe transaksioneve buxhetore të institucioneve publike në vetëm pesë ditë të afatit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.

Që nga hyrja në fuqi e kufizimeve, figurojnë të jenë kryer 51 denoncime nga subjekte politike dhe organizata të ndryshme mbi shkelje të ndryshme në raportim të aktiviteteve publike dhe përdorim të aseteve publike nga zyrtarët. Deri me 25 mars, rezultojnë nga të dhënat zyrtare të KQZ se janë marrë 31 vendime nga KQZ mbi këto denoncime, nga të cilët:

- 12 vendime për masa administrative (rasti i drejtorit të kadastrës Lushnjë dhe kryetarit të bashkisë Tiranë), të rrëzuara më pas nga shqyrtimi në Komisionin e Ankesave dhe Sanksioneve pranë KQZ;
- 1 rast vendimmarrje ndaj kryeministrit në lidhje me përdorimin e imazheve politike në platformën shqiperiaqeduam.al;
- 4 raste përfundim pa shkelje;
- 14 raste për mosfillim hetimi.

Për 20 denoncime të tjera të mbërritura në ditët e fundit vijon hetimi administrative apo janë në proces shqyrtimi nga KQZ.



*(tabela e denoncimeve në ndërfaqen e KQZ-së për aktivitete të ndaluara dhe dhe vendimmarrja e saj mund të konsultohen në [Aneksin 2 të raportit](#))*



Struktura e monitorimit në KQZ ka përfunduar rekrutimin e 64 monitoruesve në terren të fushatës zgjedhore duke mbuluar në këtë mënyrë të gjithë territorin e vendit. Raportimet nga monitoruesit nënvizojnë shkelje dhe parregullsi në njohjen dhe zbatimin e kufizimeve të Kodit Zgjedhor nga Njësitë e Qeverisjes Vendore si dhe subjekteve zgjedhore në kuadër të përdorimit të burimeve shtetërore si dhe përdorimin e materialeve propagandistike. Raportet individuale të monitoruesve publikohen në mënyrë transparente në [rubrikën përkatëse](#) të faqes së internetit të KQZ-së, por deri më tani nuk është dhënë një raport përmblendës i monitorimit në terren nga vëzhguesit e KQZ-së.

Më 9 Mars, Komisioni Rregullator miratoi [projektvendimin](#) “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit të denoncimeve”, si pjesë e mekanizmave të rinj të Kodit Zgjedhor që synojnë të rrisin rolin e KQZ si një organ që heton proaktivisht denoncimet ndaj subjekteve zgjedhore, partive politike dhe organeve të administratës publike për përdorimin e burimeve shtetërore dhe më gjerë. Portali <http://kqz.gov.al/kallzo> nisi funksion-





imin në të njëjtën ditë në faqen e internetit të KQZ-së. Gjatë këtyre ditëve të para të funksionimit, konstatohen vetëm disa denoncime të mbërritura në këtë ndërfaqe, ndërkohë që shumica e denoncimeve kanë vazhduar të adresohen nga subjektet politike dhe qytetarët përmes panelit raportues të ndërfaqes së aktiviteteve publike [aktivitete.kqz.gov.al](http://aktivitete.kqz.gov.al).

### Monitorimi në terren SETA




Gjatë kësaj periudhe, projekti SETA ka vazhduar monitorimin e aktiviteteve promovuese të anëtarët të kabinetit qeveritar dhe kryetarëve të bashkive në shtatë qytete kryesore të vendit. Këto veprimtari në faqet zyrtare online të institucioneve, mediat lokale si dhe profilet e këtyre zyrtarëve në rrjete sociale (kryesisht Facebook), u kryqëzuan më pas me të dhënat e raportimeve të këtyre institucioneve në ndërfaqen e KQZ, për të sjellë një analizë të ecurisë së procesit të raportimit dhe disa rekomandime të mëtejshme. Të dhënat e monitorimit janë filtruar më tej për të eliminuar veprimtaritë e zyrtarëve që kanë patur lidhje me situata emergjente apo çështje që nuk janë subjekt i kufizimeve të Kodit Zgjedhor.



**Tabela përmbledhëse e aktiviteteve të zyrtarëve të lartë qendrorë dhe vendorë në periudhën 1-25 mars 2021**

	Zyrtarë subjekt i raportimit	Raportime në KQZ*	Aktivitete promovuese**	Promovime të paraportuara
	Kryeministri	85	110	4
	Ministri i Mbrojtjes	4	3	1
	Ministri i Brendshëm	2	14	10
	Ministri i Drejtësisë	1	4	0
	Ministri i Financave dhe Ekonomisë	27	13	2
	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	21	11	1
	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	15	10	3
	Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme	0	3	3
	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	0	18	11
	Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	2	12	5
	Ministri i Kulturës	8	10	2
	Ministri i Mjedisit dhe Turizmit	0	13	8
	Ministri i Shtetit për Diasporën	0	0	0
	Ministri i Shtetit për Rindërtimin	8	15	2
	Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin	0	15	8
	Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	0	0	0

**KRYETARËT E BASHKIVE**

	Tiranë	18	21	6
	Durrës	8	3	3
	Shkodër	13	2	2
	Elbasan	23	5	3
	Vlorë	0	5	5
	Korçë	0	2	2
	Gjirokastër	0	2	2

\*Të dhëna zyrtare nga ndërfaqja e raportimeve e KQZ për periudhën nën monitorim.

\*\*Vizita apo postime promovuese të investimeve në infrastrukturë dhe objekte publike që mund të përbëjnë shkelje në mungesë të raportimit

Mund të konstatohet se fokusi dhe masat e para ndëshkuese në zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor ka rritur më tej numrin e ministrive dhe njësisve vendore, të cilat kanë filluar të kryejnë procedurën e raportimit të aktiviteteve të tyre në periudhën nën raportim. Megjithatë, duhet nënvizuar përsëri fakti që numri i raportimeve të zyrtarëve nuk pasqyron të gjitha aktivitetet promovuese që ndodhin në realitet prej tyre.

Gjatë kësaj periudhe, me përfshirjen e 16 nga 17 anëtarët e kabinetit qeveritar në listat e kandidatëve të subjektit zgjedhor Partia Socialiste, vihet re një rritje e mëtejshme e aktiviteteve promovuese dhe politike e ministrave që më parë ishin më të kujdesshëm. Disa prej tyre, të cilët janë ngarkuar edhe në drejtimin e fushatës në qarqe të ndryshme, sic është rasti i ministrit të brendshëm, z.Bledi Çuçi si dhe Ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Olta Xhaçka, janë shfaqur tashmë në kostumin e kandidatit në fushatë zgjedhore duke promovuar fizikisht investime në infrastrukturë rrugore dhe sociale, kanale ujitëse, rindërtime shkollash etj. Vendimi i ditëve të fundit i ministrit Çuçi për të deleguar kompetencat gjatë fushatës tek një nga zëvendësministrat, është një vendim që deri diku mund të ndihmojë ndarjen e profilit të zyrtarit nga ai i kandidatit gjatë këtyre javëve të ndezjes së motorëve të fushatës dhe që ofron një shembull edhe për zyrtarët e tjerë qendrorë dhe vendorë.



*Listën e plotë të veprimtarive të zyrtarëve të monitoruar që nga hyrja në fuqi e kufizimeve të Kodit Zgjedhor mund t'i gjeni në databazën e projektit tonë: [monitorimi.asp.al](http://monitorimi.asp.al)*

## Monitorimi i akteve normative

Në funksion të Nenin 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor, janë monitoruar Aktet Normative dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave, të cilët janë botuar në Fletoren Zyrtare për periudhën 01 – 25 mars 2021.

Rezultojnë si vendime në shkelje të Kodit Zg-

jedhor:

- 1 akt ligjor;
- 2 vendime të Këshillave Bashkiakë

të cilat sjellin **përfitime apo masa lehtësuese** për periudhën katër mujore para zgjedhjeve.

Më konkretisht aktet e miratuara mund të konsultohen në Aneksin 1.

*Listën e plotë të akteve të miratuara që nga hyrja në fuqi e kufizimeve të Kodit Zgjedhor mund t'i gjeni në databazën e projektit tonë: [monitorimi.asp.al](http://monitorimi.asp.al)*

## Rekomandime

Gjetjet e këtij raporti rikonfirmojnë dhe theksojnë edhe njëherë nevojën urgjente për të qartësuar më tej kufizimet e aktiviteteve publike të ndaluara të zyrtarëve nga Kodi Zgjedhor. [Kërkesa zyrtare](#) pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e Akademisë së Studimeve Politike, në bashkëpunim me Shoqatën për Kulturë Demokratike dhe Institutin e Studimeve Politike, për ndryshimin e rregullores ([Vendimit nr.9/2020](#)) për raportimin e veprimtarive të ndaluara të zyrtarëve të lartë publikë, e dorëzuar prej datës 3 mars 2021, vazhdon ende të mos shqyrtohet për shkak të ngarkesës së zakonshme të KQZ në këto javë të fundit para zgjedhjeve.

Në këto kushte, mbeten të vlefshme për t'u theksuar tre propozimet e paraqitura në këtë kërkesë:

- Ndryshimi i pikës 1.1 e nenit 3 të Vendimit 9/2020 duke hequr togfjalëshin “**për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar**”
- Përfshirjen e mediave sociale në përkul-

fizimin “media publike” duke evituar çdo lloj mangësie dhe inkoherence në identifikimin dhe përcaktimin se çfarë përbën “veprimtari publike”.

- Qartësimin e përgjegjësive administrative të zyrtarëve subjekt i kufizimeve të veprimtarive të ndaluara.

### Hartoi raportin:

**Isuf Shehu - Gerta Meta**

## ANEKS 1 – Aktet normative në shkelje të Kodit Zgjedhor

**1. Ligji nr. 16/2021** “Për miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare “Tirana International Airport” sh.p.k, “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar ‘Nënë Tereza’, Tiranë”, ratifikuar me ligjin nr.9312, datë 11.11.2004, të ndryshuar”.

Me Dekretin nr. 11979, datë 24.02.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, është vendosur kthimi në Kuvend për rishqyrtim të ligjit të mësipërm 16/2021; Me Vendimin nr. 26/2021 të Kuvendit të Shqipërisë është vendosur rrëzimi i Dekretit të Presidentit. Në këto kushte ligji i mësipërm hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrate, në datën 01.04.2021. - Fletore Zyrtare Nr. 41, datë 16.03.2021.

- Nëpërmjet kësaj Marrëveshje, është ligjëruar zgjatja e Koncesionit të Aeroportit të Rinasit me 13 vite, një projekt dhe in-

vestim strategjik, kombëtar me karakter ekonomik në funksion të interesit publik në përgjithësi. Në dhjetor të viti 2020 koncesioni i është shitur shoqërisë Kast-rati Group, i cili është aksioneri i 100% të aksioneve të “Tirana Inetrantional Airport”:



**Akti i mësipërm mund të përfshihet në rastet e “veprimtarive të ndaluara”, të parashikuara nga Vendimit nr. 9, datë 23.12.2020 (neni 3, pika 4) të Komisionit Rregullator të KQZ, mbi ndalimin e kontratave koncensionare dhe PPP.**

**2. Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 12, datë 01.03.2021;** “Për trajtimin me subvencionin e qirasë së disa familjeve në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë”.

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë

Këshilli Bashkiak Tiranë, nëpërmjet këtij vendimi ka vendosur:

- Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/familjet, sipas listës bashkëlidhur vendimit;
- Kohëzgjatja e pagesës së qirasë do të jetë për një periudhë 1 vjecare;
- Efektet financiare në shumën 506,205 lekë në muaj, do të përballohen nga fondi i bonusit të strehimit të Bashkisë Tiranë.



Konstatohet se ka shkelje të nenit 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor, për ndalimin e propozimit, miratimit ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, në formën e rritjes së pensioneve, mbështetjes ekonomike ose sociale etj., të cilat mund të krijojnë përfitime elektorale me ndikim të gjerë.

**5. Vendim i Këshillit Bashkiak Lezhë nr. 47, datë 17.03.2021;** “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike me fonde të buxhetit vendor për vitin 2021”.

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Lezhë Këshilli Bashkiak Lezhë, nëpërmjet këtij vendimi ka vendosur:

- Të miratojë kriteret e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike me fonde të buxhetit vendor;
- Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda 3 muajve të fundit nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe që nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit.



Konstatohet se ka shkelje të nenit 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor, për ndalimin e propozimit, miratimit ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, në formën e rritjes së pensioneve, mbështetjes ekonomike ose sociale etj., të cilat mund të krijojnë përfitime elektorale me ndikim të gjerë.



**ANEKSI 2 – Tabela e denoncimeve në ndërfaqen e KQZ-së për aktivitetet e ndaluara**

Nr	Vendimi	Ndaj	Statusi	Kategoria	Data	Hapur nga
1	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	30-Dec	LSI
2	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pronesie	30-Dec	LSI
3	Vendimi 7/ 14.01.2021	PS -MP - Arben Qalliu	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pronesie	30-Dec	LSI
4	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	30-Dec	LSI
5	Vendimi 7/ 14.01.2021	PS -MP - Arben Qalliu	Shfuqizim KAS	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	30-Dec	LSI
6	Vendimi 20/30.01.2021	Edi Rama	Mosfillim	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	3-Jan	ISP
7	Vendimi 19/30.01.2021	Kryeministri	<b>Vendimmarrje</b>	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	4-Jan	ISP
8	Vendimi 16/ 28.01.2021	Edi Rama	Mosfillim	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	5-Jan	LSI
9	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pronesie	5-Jan	LSI
10	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pronesie	5-Jan	LSI
11	Vendimi 18/30.01.2021	PS -MP - Alket Hyseni	Mosfillim	Denoncime AN - Depu- tet - Policia Takim	6-Jan	ISP
12	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pronesie	9-Jan	LSI
13	Vendimi 16/ 28.01.2021	Edi Rama	Mosfillim	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	9-Jan	LSI
14	Vendimi 16/ 28.01.2021	Edi Rama	Mosfillim	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	9-Jan	LSI
15	Vendimi 16/ 28.01.2021	Edi Rama; Elton Arbana	Mosfillim	Denoncime AN - Pro- movime Objekte Ternet	9-Jan	LSI
16	Vendimi 46/09.02.2021	Edi Rama; Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pronesie	9-Jan	LSI
17	Vendimi 46/09.02.2021	Edi Rama; Erion Veliaj	Shfuqizim KAS	Denoncime AN - Pro- movime Objekte Ternet	9-Jan	LSI
18	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj; Toni Gogu	Shfuqizim KAS	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	9-Jan	LSI
19	Vendimi 46/09.02.2021	Erion Veliaj; Xhemal Qefaliaj	Shfuqizim KAS	Shperndarje Dokumente Pronesie	9-Jan	LSI

20	Vendimi 11/25.01.2021	Autoriteti ixxxxxx	Mosfillim	(7) Sinjalizim Aktivitetete Ndaluar	11-Jan	xxx
21	Vendimi 12/25.01.2021	Bashkia Txxxxx	Mosfillim	Sinjalizime - Largim nga Puna	15-Jan	xxx
22	Vendimi 101/25.02.2021	PS -MP - Edvin Bushati	Perfundim pa Shkelje	Perdorim asetesh - Shkolla	15-Jan	ISP
23	Vendimi 10/25.01.2021	Erion Veliaj	Mosfillim	Perdorim asetesh - Shkolla	15-Jan	xxx
24	Vendimi 101/25.02.2021	PS -MP - Ervin Bushati	Perfundim pa Shkelje	Perdorim asetesh - Shkolla	15-Jan	Qen- dresa Qytet- are
25	Vendimi 41/09.02.2021	PS-KB-Sotiraq Filo	Mosfillim	Denoncime AN - Pro- movime Objekte Termet	19-Jan	LSI
26	Vendimi 42/09.02.2021	PS-MP-Mimi Kodheli	Mosfillim	Denoncime AN - Depu- tet - Policia Takim	19-Jan	LSI
27	Vendimi 40/09.02.2021	Drejtoria Rajo- nalexxxx	Mosfillim	Sinjalizime - Largim nga Puna	24-Jan	xxx
28	Vendimi 102/25.02.2021	PS -MP - Elona Gjebrea	Perfundim pa Shkelje	Perdorim asetesh - Shkolla	28-Jan	Qen- dresa Qytet- are
29		Erion Veliaj	Hetim Adminis- trativ	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	2-Feb	LSI
30		Erion Veliaj	Hetim Adminis- trativ	Denoncime Aktivitete te Ndaluar	2-Feb	LSI
31		Erion Veliaj	Hetim Adminis- trativ	Promovime Objekte Termet	2-Feb	LSI
32		Erion Veliaj	Hetim Adminis- trativ	Promovime Objekte Termet	2-Feb	LSI
33	Vendimi 103/25.02.2021	Bujar Cela	Mosfillim	Promovime Objekte Termet	2-Feb	LSI
34		Erion Veliaj	Hetim Adminis- trativ	Promovime Objekte Termet	2-Feb	LSI
35		Erion Veliaj	Hetim Adminis- trativ	Promovime Objekte Termet	2-Feb	LSI
36		Erion Veliaj	Hetim Adminis- trativ	Promovime Objekte Termet	2-Feb	LSI
37		Bashkia Durres	Hetim Adminis- trativ	Kontrata Publike/ Asete	2-Feb	PD
38	Vendimi 104/26.02.2021	Bashkia Tropoje	Perfundim pa Shkelje	Promovime Investime/ objekte	10-Feb	PD
39		Bashkia Vore	Hetim Adminis- trativ	Mospermbushje Dety- rime-Subjekte	16-Feb	LSI

40	Vendimi 122/ 8.3.2021	PS-KPD- Arben Mucaj	Mosfillim	Denoncime Kandidat per Deputet-Paregjis- truar	17-Feb	xxx
41		Keshilli i Min- istrave	Shqyrtim Para- prak	Kontrata Publike/ Asete	22-Feb	PD
42		Keshilli i Min- istrave	Shqyrtim Para- prak	Kontrata Publike/ Asete	1-Mar	PD
43		Bashkia Kukes	Shqyrtim Para- prak	Detyrim Administrata	16-Mar	PD
44		Bashkia Tropoje	Shqyrtim Para- prak	Venie ne perdorim asetete	18-Mar	PD - Tropoje
45		Bashkia Tirane	Shqyrtim Para- prak	Venie ne perdorim asetete	18-Mar	Qen- dresa Qytet- are
46		Bashkia Kukes	Shqyrtim Para- prak	Venie ne perdorim asetete	18-Mar	Qen- dresa Qytet- are
47		Bashkia Tirane	Shqyrtim Para- prak	Venie ne perdorim asetete	19-Mar	Qen- dresa Qytet- are
48		Shtepia e te moshuarve Shkoder	Shqyrtim Para- prak	Venie ne perdorim asetete	19-Mar	Qen- dresa Qytet- are
49		Bashkia Belsh	Shqyrtim Para- prak	Materiale Propagandis- tike	19-Mar	PD
50		ATSH	Shqyrtim Para- prak	Venie ne perdorim asetete	20-Mar	PD
51		Ministria e Finan- cave	Shqyrtim Para- prak	Kontrata Publike/ Asete	23-Mar	PD